

20080881656

LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN
E OBLIGUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005 dhe 29/2007) në nenin 1 paragrafi (3), pas fjalës "Agjencia" vihet pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Neni 2

Në nenin 2 paragrafi (1) pas fjalës: "ligj" shtohen fjalët: "dhe shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare, të themeluar në pajtim me Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital".

Neni 3

Në nenin 3 paragrafi (1) pikat 1), 2), 3) dhe 7) ndryshojnë si vijojnë:

1) "**Shoqëri**" është shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale, që është e themeluar dhe punon në pajtim me këtë ligj.

2) "**Fond i obligueshëm pensional**" është fondi i hapur investues, i themeluar dhe i menaxhuar nga shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale dhe shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale.

3) "**Agjenci për supervizionin e sigurimit pensional me financim kapital**" është agjencia të cilës i është ngarkuar supervizioni i punës së shoqërive për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale dhe skemave profesionale pensionale në pajtim me këtë ligj.

7) "**Bartje e mjeteve**" është bartja e mjeteve nga llogaria e anëtarit e hapur në një fond pensional në fondin tjetër pensional, me të cilin menaxhon shoqëria tjetër për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale ose shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale."

- Pas pikës 8) shtohen tri pika të reja 9), 10) dhe 11) si vijojnë:

9) "**Provizione të transaksionit**" janë kompensimi për bursën e letrave me vlerë, kompensimi për depozitarin e letrave me vlerë dhe provizioni për personat juridikë që kryejnë shërbime me letra me vlerë, të lidhur drejtpërdrejt me tregti me mjetet e fondeve pensionale.

10) "**Shoqëri për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale**" është shoqëria aksionare që menaxhon me fondin e obligueshëm dhe me fondin vullnetar pensional, në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për sigurimin vullnetar pensional me financim kapital.

11) "**Shoqëri pensionale**" është shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale, shoqëria për menaxhimin e me fondet vullnetare pensionale dhe shoqëria për menaxhimin me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale."

Neni 4

Në nenin 4 pas fjalës "rregulluar" vihet pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Neni 5

Në nenin 7 paragrafi (2) dhe (3), pas fjalës: "shoqëria" shtohen fjalët: "dhe shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në nenin 11 paragrafi (2) pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: "që mbahet në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë."

Në paragrafin (3) fjalët: "Gjyqi ku mbahet regjistri tregtar", zëvendësohen me fjalët: "Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë".

Neni 7

Në nenin 13 paragrafi (1) pas fjalës "ligji" shtohen fjalët: "llogaritur sipas metodologjisë".

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

"(5) Metodologjinë e përlogaritjes së kapitalit nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton Agjencia."

Neni 8

Në nenin 16 paragrafët (5) dhe (6) ndryshojnë si vijojnë:

"(5) Nëse ekzistojnë vetëm dy shoqëri, njëra shoqëri nuk mund të blejë aksione nga shoqëria tjetër për menaxhim me fonde pensionale dhe ato nuk guxojnë të bashkohen, bashkëngjiten, ndahen apo në mënyrë tjetër të riorganizohen.

(6) Nëse ekzistojnë më tepër se dy shoqëri, njëra shoqëri nuk mund të blejë aksione nga shoqëria tjetër për menaxhim me fonde pensionale, përveç në rastin e bashkimit apo bashkëngjitjes së shoqërive."

Neni 9

Në nenin 17 paragrafi (3) pika v) fjalët: "masa e sigurisë" zëvendësohen me fjalët: "sanksioni kundërvajtës".

Neni 10

Në nenin 20 paragrafi (1) pika a) pas fjalës "persona" fjalët: "duke i përfshirë edhe shoqëritë e tjera për menaxhim me fonde pensionale" fshihen.

Neni 11

Në nenin 21 paragrafi (1), (2) dhe (5), nenin 41, 44, 45 paragrafi (1) pika v), nenin 59 paragrafi (7) dhe (9), nenin 68 paragrafi (2) dhe (3) pika b), nenin 72, 78, 87 paragrafi (1) pika b), nenin 97, 102 paragrafi (2) dhe (3), nenin 104 paragrafi (2), nenin 108 paragrafi (1) pika d) nënpika 1), nenin 109, 112, 113 paragrafi (1), nenin 117 paragrafi (1) pika d) dhe paragrafi (2), nenin 118 paragrafi (2), nenin 119 paragrafi (1), nenin 120 paragrafi (4), nenin 121 paragrafi (2), nenin 122 paragrafin (1) dhe (2), nenin 123 paragrafi (2) dhe nenin 126 paragrafi (1), (2) dhe (5), pas fjalës "shoqëria" me njëj dhe numër të ndryshëm shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 12

Pas nenit 21 shtohet neni i ri 21-a, si vijon:

"Neni 21-a

- (1) Shoqëria është e obliguar që të ketë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm, e cila për punën e vet mban përgjegjësi para këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.
- (2) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen kontroll të përhershëm dhe të tërësishëm të ligjshmërisë dhe përditësimit të punës së shoqërisë, veçanërisht përmes:
 - a) Përcjelljes së zbatimit të dispozitave;
 - b) Përcjelljes së zbatimit të procedurave dhe politikave interne dhe
- v) Vlerësimit të efikasitetit të përgjithshëm të punës së shoqërisë
- (3) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, përgatit program vjetor të punës për vitin e ardhshëm dhe raport për revizionin e brendshëm për vitin paraprak dhe ia dorëzon për miratim këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, më së voni deri më 31 mars.
- (4) Personi i punësuar në njësinë organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen punë vetëm për revizionin e brendshëm.
- (5) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, është e obliguar që t'i dorëzojë programin dhe raportin nga paragrafi (3) i këtij neni në Agjenci, njëkohësisht me dorëzimin e tyre në Këshillin mbikëqyrës të shoqërisë."

Neni 13

Në nenin 22 shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Shoqëria është e obliguar që ta publikojë ekstraktin e raportit të reviduar financiar me mendimin e revizorit të autorizuar, në së paku një gazetë ditore dhe në ueb faqen e vet, në afat prej 15 ditësh nga miratimi i raportit nga ana e Kuvendit të shoqërisë."

Neni 14

Pas nenit 22 shtohet neni i ri 22-a, si vijon:

"Neni 22-a

- (1) Përfaqësuesit e shoqërive detyrimisht marrin pjesë në trajnime nga sfera e sigurimit pensional me financim kapital, të organizuara nga Agjencia.
- (2) Agjencia e përcakton llojin e trajnimeve dhe mënyrën e realizimit të tyre."

Neni 15

Pas nenit 39 shtohet Kreu i ri III a, me titullin si vijon: "THEMELIMI I SHOQËRIVE PËR UDHËHEQJE ME FONDET PENSIONALE" dhe dhjetë nene të reja 39-a, 39-b, 39-v, 39-g, 39-d, 39-gj, 39-e, 39-zh, 39-z dhe 30-x, si vijojnë:

"Neni 39-a

(1) Shoqëria për udhëheqje me fondet pensionale, themelohet në bazë të lejes nga Agjencia dhe udhëheq me fondin pensional në bazë të lejes për udhëheqje me fondin pensional.

(2) Në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, mund të kryhet regjistrimi i shoqërisë vetëm nëse ajo ka leje nga Agjencia, e lëshuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia më afërsisht i përcakton mënyrën dhe procedurën për marrjen e lejes për themelimin dhe lejes për udhëheqje me fondin pensional.

Neni 39-b

(1) Për marrjen e lejes për themelimin e shoqërisë, personat e interesuar dorëzojnë në Agjenci kërkesë me dokumentacionin e shkëputur në nenin 39v të këtij ligji, dhe planin afarist që i përmban hollësitë për të gjitha kompensimet dhe provizionet që do të paguheshin në pajtim me këtë ligj. Kërkesa për leje për udhëheqje me fondin pensional, dorëzohet bashkë me kërkesën për leje për themelimin e shoqërisë.

(2) Kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohen të nënshkruara nga nënshkruarit e autorizuar të personit ose personave, që do të ishin themelues të shoqërisë, në formën e përcaktuar nga Agjencia. Në rast se ka më tepër persona që kanë interes të paraqiten si një kërkuar, kërkesat me dokumentacionin dorëzohen bashkërisht në emër të të gjithë personave.

Neni 39-v

(1) Kërkesës nga neni 39-b paragrafi (1) i këtij ligji, i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:

- a) projektstatuti i shoqërisë;
- b) projektstatuti i fondit pensional me të cilin udhëhiqet;

v) projekt marrëveshja me ruajtësin e pronës;

g) deklarata e nënshkruar nga nënshkruarit e autorizuar të të gjithë personave që do të ishin themelues, se nëse marrin leje do të themelojnë shoqëri dhe fond pensional, në pajtim me këtë ligj;

d) lista e themeluesve dhe të dhënat për lidhjen e personave juridikë, dhe sqarimet për karakterin e asaj lidhjeje;

gj) për të gjithë personat që do të ishin themelues, kopje të vërtetuara nga aktet themeluese dhe statutet e shoqërive dhe ekstrakti nga organi kompetent në të cilin janë regjistruar, emrat dhe adresat e anëtarëve të këshillave drejtuese dhe kopjet e vërtetuara nga tre raportet e fundit financiare të reviduara nga revizori i jashtëm i autorizuar, si dhe çdo dëshmi plotësuese e nevojshme që të dëshmohet se janë plotësuar kushtet nga neni 15 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji;

e) dokumentet me të cilat vërtetohet se në datën e paraqitjes së kërkesave, themeluesit që do të mbajnë 51% të kapitalit themelues të shoqërisë, kanë përvojë të madhe në udhëheqje me mjete dhe kanë rejting të rekomandueshëm për investim, sipas agjencive ndërkombëtare kreditore me rejting me renome, së paku për periudhën prej një viti para se të paraqiten si themelues;

zh) dëshmia për prejardhjen e mjeteve financiare, që do të paguheshin në emër të kapitalit themelues të shoqërisë;

z) lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, bashkë me deklaratat me të cilat ata pajtohen që t'i kryejnë këto funksione nëse marrin leje për themelimin, dhe t'i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë ligj, duke përfshirë tërheqjen nga çfarëdo funksioni që paraqet konflikt të interesave dhe është i ndaluar me këtë ligj, si dhe përshkrimin e kualifikimeve të tyre profesionale dhe të përvojës së përparshme profesionale;

x) të dhënat për personat me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, të cilët propozohet të jenë përgjegjës për vendimet investuese;

i) certifikatat se personave që janë anëtarë të organeve të udhëheqjes dhe administrimit të shoqërisë, nuk u është kumtuar sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në sferën juridike, bankare, të kontabilitetit, sigurimit, menaxhimit me mjete dhe investimit, udhëheqjes me fonde pensionale dhe shërbime financiare;

j) plani për implementimin e themelimit të shoqërisë dhe fondit pensional, si dhe plani organizativ për strukturën e shoqërisë;

k) programi për strategjinë investuese të fondit pensional dhe

ll) dokumente të tjera të nevojshme që i përcakton Agjencia.

(2) Në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave nga neni 39-b paragrafi (1) i këtij ligji, Agjencia mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave plotësuese.

(3) Agjencia mundet në mënyrë plotësuese që të analizojë fakte të veçanta lidhur me kërkesat dhe dokumentacionin, dhe për këtë qëllim mundet:

a) të drejtohet se organet dhe institucionet e tjera kompetente rregulluese dhe të supervizionit, në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit dhe

b) të grumbullojë dokumente dhe të dhëna nga burimet e tjera.

Neni 39-g

Agjencia u lëshon leje për themelimin dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional personave të interesuar, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave nga neni 39-v i këtij ligji, nëse nuk është në kundërshtim me interesat e të siguruarve të cilët do të mund të anëtarësoheshin në fondin e ardhshëm pensional, i cili do të themelohet në bazë të këtij ligji dhe sipas vlerësimit për plotësimin e kushteve si vijojnë:

a) nga dokumentet dhe të dhënat e marra rezultan se nëse jepet leje, në shoqërinë e propozuar do të paguhet kapitali themelues i përcaktuar me këtë ligj;

b) nga dokumentet dhe të dhënat në disponim, rezulton se kërkuesit disponojnë me mjete financiare për atë dedikim;

v) nga dokumentet dhe të dhënat në disponim, rezulton se kërkuesit i plotësojnë kushtet për themelues, nga nenet 14 dhe 15 të këtij ligji;

g) nga dokumentet dhe të dhënat në disponim, rezulton se personat e propozuar për anëtarë të këshillit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës dhe personat përgjegjës për menaxhim investues, i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj;

d) dokumentet e paraqitura në pajtim me nenin 39-v të këtij ligji, përmbajnë dispozita që nuk do t'i rrezikojnë interesat e anëtarëve të fondit pensional, ose në ato dokumente nuk janë lëshuar dispozitat me të cilat në masë të konsiderueshme, janë të mbrojtura ato interesa;

gj) kërkuesit kanë dëshmuar se kanë siguruar ose do të sigurojnë lidhjen e marrëveshjeve me kohë, për kontabilitetin financiar dhe revizionin e shoqërisë, në pajtim me këtë ligj;

e) emri i propozuar i shoqërisë së ardhshme ose emri i fondit të ardhshëm pensional, nuk do t'u shkaktojë huti anëtarëve të fondit, anëtarëve të ardhshëm ose cilitdo person tjetër, që do të mund të ketë kontakte me shoqërinë dhe fondin pensional;

zh) puna e shoqërisë dhe e fondit pensional do të kryhet në pajtim me standardet e udhëheqjes me fonde pensionale dhe zakonet e mira afariste dhe

z) nga dokumentet dhe të dhënat rezulton se shoqëria e ardhshme nuk do të kryejë veprimtari të tjera, përveç atyre për të cilat është autorizuar në bazë të këtij ligji, dhe të cilat drejtpërdrejt janë të lidhura me udhëheqje me fondin pensional.

Neni 39-d

(1) Agjencia merr vendim për kërkesat nga neni 39-b paragrafi (1) i këtij ligji, në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesave.

(2) Personave të interesuar të cilëve u janë pranuar kërkesat, Agjencia u lëshon leje për themelim dhe leje të kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional.

(3) Personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leje për themelim dhe leje e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional, janë të obliguar që të themelojnë shoqëri në pajtim me dokumentacionin e paraqitur, në bazë të Ligjit për shoqëri tregtare dhe të këtij ligji. Shoqëria doemos duhet të themelohet në afatin prej 90 ditësh nga pranimi i lejes, ndërsa për shkaqe të arsyeshme Agjencia mund ta vazhdojë afatin për më së shumti 90 ditë.

(4) Nëse personat e interesuar të cilëve u është lëshuar leja për themelim, nuk themelojnë shoqëri në afatin e përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni, pas kalimit të atij afati Agjencia do t'ia heqë lejen për themelim.

Neni 39-gj

(1) Personave të interesuar të cilëve nuk u është lëshuar leje, Agjencia u dërgon vendim me arsyetimin e refuzimit. Këto vendime janë të kapshme për opinionin.

(2) Kundër vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi i interesuar mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

Neni 39-e

(1) Shoqëria e njofton Agjencinë për themelimin dhe regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, në afatin prej 30 ditësh nga regjistrimi i kryer. Shoqëria është e obliguar që të dorëzojë kopjet e vërtetuara nga aktet themeluese dhe statuti i shoqërisë, versionet e fundit të dokumenteve nga neni 30-v paragrafi (1) pikat (b) dhe (v) të këtij ligji, kopjen nga leja e kushtëzuar nga neni 39-g i këtij ligji, dhe dokumente të tjera lidhur me punën me fondin pensional, të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Pas plotësimit të kushteve të parapara në nenin 39-d paragrafi (3) i këtij ligji dhe paragrafi (1) i këtij neni, leja e kushtëzuar për udhëheqje me fondin pensional bëhet e plotfuqishme.

(3) Shoqëria nuk mund të fillojë me aktivitetet e udhëheqjes me fondin pensional, si dhe marketingut dhe analizës së mendimit publik, para marrjes së lejes për themelim, lejes për udhëheqje me fondin pensional dhe para regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 39-zh

Të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, personave me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, ose ndryshimet dhe plotësimet e dokumenteve dhe të dhënave të shënuara në nenin 39-v të këtij ligji, i nënshtrohen pëlqimit paraprak nga ana e Agjencisë, përveç nëse ndryshimet janë jashtë kontrollit të shoqërisë, ndërsa ajo i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për pengimin e atyre ndryshimeve. Agjencia i vlerëson ndryshimet e atilla, në pajtim me dispozitat nga neni 39-g i këtij ligji.

Neni 39-z

(1) Agjencia mund ta tërheqë ose ta heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional, për shkaqet e njëjta për të cilat e refuzon kërkesën sipas nenit 39-v të këtij ligji, për shkak të mosplotësimit të kushteve nga neni 39-g i këtij ligji, pas krijimit të kushteve nga nenet 13 paragrafi (4), 53 paragrafi (6), 126 paragrafi (1) dhe 143 paragrafi (4) të këtij ligji, për shkak të keqpërdorimit të të dhënave për të siguruarit dhe anëtarët e shpërndarë përkohësisht, ose në raste të tjera të shkeljes së madhe të dispozitave të këtij ligji dhe me kërkesën e shoqërisë.

(2) Para se ta tërheqë ose heqë lejen për udhëheqje me fondin pensional, Agjencia do ta thërrasë shoqërinë dhe do t'i japë mundësi që t'i evitojë paligjshmëritë dhe parregullsitë në punë, në afatin e përcaktuar nga Agjencia, përveç nëse konsideron se mundësia e atillë do të ishte në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional ose të interesit publik.

(3) Agjencia menjëherë e njofton shoqërinë për vendimin e tërheqjes ose heqjes së lejes për udhëheqje me fondin pensional.

(4) Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

(5) Agjencia më afërsisht e rregullon procedurën e tërheqjes ose heqjes së lejes për udhëheqje me fondin pensional, nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 39-x

(1) Shoqëria të cilës i është tërhequr leja për udhëheqje me fondin pensional në bazë të nenit 39-z të këtij ligji, vazhdon që të punojë nën mbikëqyrjen e Agjencisë, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, pas pajtimit paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Nëse shoqërisë i hiqet leja për udhëheqje me fondin pensional në bazë të nenit 39-z të këtij ligji, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondeve pensionale, Agjencia e ndërmerri administrimin dhe udhëheqjen me atë fond pensional, deri në plotësimin e kushteve nga paragrafi (3) i këtij neni, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia pas pajtimit paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(3) Kur vendimi për heqjen e lejes bëhet përfundimtar dhe nëse ka së paku dy shoqëri, Agjencia i shpërndan anëtarët në fondet pensionale ekzistuese me të cilat udhëheqin ato shoqëri, në pajtim me nenin 58 paragrafi (8) i këtij ligji, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

Neni 16

Në nenin 45 paragrafi (1) pika b) fjala "brokere" zëvendësohet me fjalën "transaksionale".

Neni 17

Në nenin 46 paragrafi (1) fjalët: "shoqërive për menaxhim me fonde pensionale dhe fondeve pensionale" zëvendësohen me fjalët: "shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (2) pas fjalës: "personit" shtohen fjalët: "me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj".

Në paragrafin (7) fjalët: "fondeve pensionale" zëvendësohen me fjalët: "fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 18

Neni 47 ndryshohet si vijon:

"(1) Agjencia i kryen punët si vijojnë:

a) realizon aktivitete për grumbullimin e kërkesave për themelimin e shoqërive pensionale, lëshon, tërheq dhe heq leje për themelimin e shoqërive pensionale, lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë së menaxhimit me fonde pensionale vullnetare, leje për kryerjen e veprimtarisë së menaxhimit me fonde pensionale të obligueshme dhe lëshon leje për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare;

b) e kryen supervizionin e punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale me të cilat ato menaxhojnë, e veçanërisht e kontrollon punën e ligjshme të të njëjtave;

v) e kryen supervizionin e punës së personave juridikë që janë ruajtës të mjeteve të fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare dhe të menaxherëve të huaj të mjeteve të fondit pensional të obligueshme dhe/ose vullnetare, lidhur me punën me ato mjete;

g) e promovon, e organizon dhe e nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale;

d) e zhvillon vetëdijen e opinionit për qëllimet dhe principet e shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare, për përfitimet nga anëtarësimi në fondin pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar, duke i përfshirë edhe qëllimet, principet dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe për çështje të tjera lidhur me sigurimin pensional me financim kapital;

gj) jep propozim për ngritjen e procedurave kundërvajtëse dhe penale para organit kompetent kundër shoqërive pensionale, ruajtësve të pronës së fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare, menaxherëve të huaj të mjeteve dhe personave të tjerë, në rastin e cenimit të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera;

e) i përcjell dhe i shqyrton raportet financiare të fondeve pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe të shoqërive pensionale;

zh) e mban regjistrin e agjentëve;

z) për sigurimin e supervizionit dhe rregullativës efikase të sigurimit pensional me financim kapital dhe të sektorit financiar, bashkëpunon me Ministrinë e Financave, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Komisionin e letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe me organizata dhe institucione të tjera në vend dhe jashtë. Madhësia, përmbajtja dhe forma e bashkëpunimit më detalisht në mënyrë të ndërsjellë i rregullon Agjencia me organet dhe institucionet kompetente;

x) bashkëpunon me Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, në pjesën e autorizimeve që i janë ngarkuar atij fondi me këtë ligj;

i) miraton akte në pajtim me këtë ligj dhe në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital;

j) miraton udhëzime interne për punën e vet dhe përgatit udhëzime profesionale, doracakë dhe ngjashëm, lidhur me sigurimin pensional me financim kapital;

k) e inicon miratimin e dispozitave dhe akteve të tjera lidhur me shoqëritë pensionale dhe me fondet pensionale, me të cilat ato menaxhojnë;

ll) anëtarësohet dhe merr pjesë në organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kur anëtarësimi i atillë është në interes të sistemit pensional maqedonas dhe

l) kryen punë të tjera në pajtim me këtë ligj dhe në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital.

(2) Aktet dhe dispozitat që Agjencia i miraton në pajtim me këtë ligj, botohen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 19

Në nenin 48 fjala "shoqërisë" dhe fjala "shoqëritë" zëvendësohen me fjalët: "shoqërive pensionale" ndërsa fjalët: "fondeve pensionale" zëvendësohen me fjalët: "fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare".

Neni 20

Neni 49 ndryshon si vijon:

"(1) Në Agjenci mund të parashtrihen ankesa nga anëtarët e fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare ose anëtarët e përparshëm të atyre fondeve pensionale kundër shoqërive pensionale, për veprimtaritë dhe aktivitete të ndërmarrja nga ato shoqëri, që nuk janë në pajtim me ligjin dhe aktet e atyre shoqërive.

(2) Në Agjenci mund të parashtrihen ankesa nga anëtarët e fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare, kundër personave të tjerë me të cilët ato fonde pensionale dhe shoqëri pensionale kanë pasur marrëdhënie afariste ose kontraktuese, në rastin kur anëtari beson se interesat e tij si anëtar i fondit pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar janë dëmtuar si rezultat i cenimit të këtij ligji, ose Ligjit për sigurimin vullnetar pensional me financim kapital nga ai person, në aspektin e marrëdhënieve afariste apo kontraktuese.

(3) Agjencia mund t'i drejtohet shoqërisë pensionale kundër të cilës ka marrë ankesë për sqarimin e rastit, nëse kjo nuk i dëmton interesat e parashtruesit të ankesës.

(4) Agjencia mban evidencë të ankesave kundër shoqërive pensionale, në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, dhe për këtë publikon të dhëna statistikore në prospektin e vet informativ."

Neni 21

Në nenin 50 paragrafi (2) pika v) fjalët: "fondet pensionale" zëvendësohen me fjalët: "fondet pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare".

Në paragrafin (6) pas pikës g) pika zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohen dy pika të reja d) dhe gj) si vijojnë:

"d) e përcakton lartësinë maksimale të kompensimit nga neni 98 paragrafi (1) pika a) e këtij ligji dhe

gj) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me statutin e Agjencisë."

Në paragrafin (7) fjalët: "dhe g)" zëvendësohen me fjalët: "g) dhe d)".

Pas paragrafit (7) shtohet paragrafi i ri (8) si vijon:

"(8) Kundër vendimit të Këshillit drejtues të Agjencisë, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjyqin kompetent. Padia nuk e prolongon zbatimin e vendimit."

Neni 22

Në nenin 51 paragrafi (4) pika v) fjalët: "fondet pensionale" zëvendësohen me fjalët: "fondet pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare".

Në pikën d) dhe paragrafin (6) pika v) fjalët: "masa e sigurisë zëvendësohen me fjalët: "sanksioni kundërvajtës".

Paragrafi (9) ndryshohet si vijon:

"Personat me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta të punësuar në Agjenci, që marrin pjesë në marrjen e vendimeve me ndikim të rëndësishëm për fondet pensionale, fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare dhe anëtarët, doemos duhet ta kenë arsimin sipëror dhe përvojë pune prej së paku tre vitesh në sferën e menaxhimit me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, ekonomisë, financave, kontabilitetit, investimit, sigurimit, shkencës aktuale apo drejtësisë."

Neni 23

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"(1) Drejtori, zëvendësdrejtori dhe të punësuarit në Agjenci, nuk guxojnë që:

a) të pranojnë çfarëdo kompensime apo pagesa, të pranojnë ndonjë funksion apo punësim, ose të kryejnë shërbime ose të përfitojnë aksione në:

1) shoqëri pensionale ose në fond pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar me të cilin ajo shoqëri menaxhon;

2) ruajtës të pronës së fondit pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar ose

3) themelues të shoqërisë pensionale dhe

b) me përjashtim nga pika a) e këtij paragrafi, personat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të përfitojnë aksione më së tepërmi deri në 5% të ruajtësi i pronës së fondit pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar dhe të themeluesit e shoqërisë pensionale.

(2) Kufizimet e përcaktuara në paragrafin (1) pika a) e këtij neni, vlejnë edhe për kohën prej një viti pas pushimit të funksionit të drejtorit të Agjencisë dhe të zëvendësdrejtorit edhe pas pushimit të vendit të punës të të punësuarve në Agjenci."

Neni 24

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"(1) Për kryerjen e obligimeve të veta Agjencia është e autorizuar që:

a) t'i marrë për shikim të gjitha dokumentet e shoqërive pensionale dhe evidencën elektronike, lidhur me punën e tyre dhe me punën e fondeve pensionale me të cilat menaxhojnë;

b) t'i marrë për shikim të gjitha dokumentet dhe evidencën elektronike nga pika a) e këtij paragrafi, nga ruajtësi i pronës dhe nga menaxheri i huaj i fondeve pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare;

v) t'i marrë për shikim të gjitha dokumentet dhe evidencën elektronike nga siguruesi, për mënyrën e organizimit dhe financimit të skemës profesionale pensionale;

g) të marrë informata nga anëtarët e këshillit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës dhe personat e tjerë të punësuar në subjektet nga pika a), b) dhe v) të këtij paragrafi, lidhur me aktivitetet e shoqërisë pensionale, fondit pensional të obligueshëm dhe/ose vullnetar ose skemës profesionale pensionale;

d) të kërkojë deklarata me shkrim dhe të nënshkruara personalisht, nga personat e shënuar në pikën g) të këtij paragrafi.

(2) Drejtori i Agjencisë mund ta autorizojë personin që të hyjë në lokalet zyrtare të:

a) shoqërisë pensionale, për kontroll dhe inspektim të ligjshmërisë së punës të asaj shoqërie pensionale dhe të fondit pensional me të cilin menaxhon dhe kontrollin e zbatimit të statutit dhe akteve të tjera të asaj shoqërie;

b) ruajtësit të pronës dhe menaxherit të huaj të mjeteve, për inspektim dhe kontroll të ligjshmërisë së punës dhe në zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara me shoqërinë përkatëse pensionale dhe

v) siguruesit, për kontroll dhe inspektim të ligjshmërisë në organizimin dhe financimin e skemës profesionale pensionale.

(3) Shoqëria pensionale, ruajtësi i pronës, menaxheri i huaj i mjeteve dhe siguruesi, janë të obliguar që personit të autorizuar për kontroll t'ia japin në disponim të gjitha librat, dokumente dhe evidencat e tjera lidhur me punën e shoqërisë pensionale,

fondit pensional me të cilin menaxhon ajo shoqëri, menaxherit të huaj të mjeteve, ruajtësit të pronës, si dhe organizimin dhe financimin e skemës profesionale pensionale.

(4) Lloji dhe vëllimi i kontrollit përcaktohet me aktvendimin për kontroll, që e miraton drejtori i Agjencisë.

(5) Personi i autorizuar për kontroll përpilon procesverbal dhe të njëjtin e dorëzon në Agjenci. Nëse Agjencia konfirmon parregullsi në punë ose në mbajtjen e librave afariste, me aktvendim do ta urdhërojë shoqërinë, ruajtësin e pronës, menaxherin e huaj të mjeteve ose siguruesin, që të njëjtat t'i evitohet në afatin e caktuar.

(6) Në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, shoqëria pensionale, ruajtësi i pronës, menaxheri i huaj të mjeteve ose siguruesi, janë të obliguar që në afatin e caktuar t'i evitohet parregullsitë dhe të dorëzojnë njoftim në Agjenci për parregullsitë e evituara, me dëshmitë e bashkëngjitura se parregullsitë janë evituar apo përmirësuar. Nëse shoqëria pensionale nuk i eviton parregullsitë, Agjencia mund ta heqë lejen për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe /ose vullnetare të asaj shoqërie.

(7) Nëse Agjencia gjatë kryerjes së kontrollit në punën e shoqërisë pensionale dhe menaxhimin me fondet pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare, konfirmon se ekzistojnë punë apo vepra që ndëshkuese sipas ligjit, drejtori apo personi i autorizuar prej tij, parashtron fletëparaqitje për ngritjen e procedurës në gjyqin kompetent.

(8) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën e kryerjes së kontrollit të shoqërive pensionale.”

Neni 25

Neni 54 ndryshohet si vijon:

“(1) Agjencia publikon raport për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, deri më 30 qershor të viti rrjedhës. Raporti përmban të dhëna për sigurimin pensional me financim kapital, vlerësimin e zbatimit të dispozitave në sferën e sigurimit pensional me financim kapital, dhe çështje të tjera për të cilat Agjencia konsideron se janë me rëndësi për sigurimin pensional me financim kapital.

(2) Agjencia paraqet raport për punën e vet për vitin paraprak në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, deri më 30 qershor të vitit rrjedhës. Raporti për punën e Agjencisë miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe i njëjti i dorëzohet për informim Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.”

Neni 26

Në nenin 55 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e këshillit drejtues, drejtori, zëvendësdrejtori, të punësuarit në Agjenci dhe personat e tjerë nuk guxojnë që të japin ose shfrytëzojnë për përdorim personal kurrfarë informata që i kanë marrë gjatë kryerjes së funksioneve ose autorizimeve në bazë të këtij ligji, dhe të cilat janë të klasifikuara me shkallën përkatëse të fshehtësisë në pajtim me ligjin. Informatat duhet të ruhen edhe pesë vite pas shuarjes së funksionit ose autorizimit, përkatësisht pushimit të vendit të punës në Agjenci.”

Në paragrafin (3) në pikat v) dhe g) fjalët: “fondet pensionale” në nyjë dhe numër të ndryshëm zëvendësohen me fjalët: “fondet pensionale të obligueshme dhe/ose vullnetare”, ndërsa fjala “shoqëritë” në nyjë dhe numër të ndryshëm zëvendësohet me fjalët: “shoqëritë pensionale”.

Neni 27

Në nenin 56 në paragrafin (3) dhe në pikën a) fjala “shoqërive” zëvendësohet me fjalët: “shoqërive pensionale”.

Në pikën b) fjalët: “dokumentacionin e tenderit” zëvendësohen me fjalët: “formularët e kërkesave dhe dokumentacionit me kërkesat për leje për themelimin e shoqërisë dhe leje për menaxhim me fondin pensional”.

Pika v) ndryshohet si vijon:

“v) kompensimi për leje për themelimin e shoqërisë pensionale, leje për kryerjen e veprimtarisë menaxhim me fonde vullnetare pensionale, leje për kryerjen e veprimtarisë menaxhim me fonde të obligueshme pensionale dhe për leje për menaxhim me fonde të obligueshme dhe/ose vullnetare pensionale;”.

Neni 28

Në nenin 57 paragrafi (2) pas fjalës “ligj” shtohen presje dhe fjalët: “Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital”.

Neni 29

Në nenin 58 paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“Gjatë sistemimit të të siguruarve në fondet pensionale, në pajtim me paragrafin (7) të këtij neni, Agjencia siguron që numri i të siguruarve që sistemohet në secilin fond të veçantë, të përcaktohet sipas të ardhurave të fondit pensional dhe lartësisë së kompensimit nga neni 98 paragrafi (1) pika a) e këtij ligji, që e arkëton shoqëria që menaxhon me atë fond pensional, në datën që e përcakton Agjencia.”

Neni 30

Në nenin 59 paragrafi (1) pas pikës, shtohet fjalia e re si vijon:

“Shoqëria është e obliguar që me bashkë me marrëveshjen për anëtarësim, të siguruarit t'i dorëzojë ekstrakt për heqjen e marrëveshjes.”

Neni 31

Në nenin 61 në paragrafët (1) dhe (7) pika b) fjalët: “Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë”, zëvendësohen me fjalën “Agjencia”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Në afat prej tetë ditësh pune nga pranimit i marrëveshjes së përkohshme për anëtarësim, Agjencia me shkrim e njofton anëtarin e fondit pensional se e ka marrë marrëveshjen e përkohshme për anëtarësim me formularin, dhe se për kalimin nga fondi ekzistues në fondin e ardhshëm pensional është i obliguar që të paguajë kompensim me para, në pajtim me nenin 98 paragrafi (1) pika v) e këtij ligji. Kalimi mund të kryhet vetëm nëse anëtari që do të kalojë në fondin e ardhshëm pensional, e plotëson dhe e kthen formularin bashkë me dëshminë për kompensimin e kryer, në afat prej tetë ditësh pune nga pranimit i njoftimit, me këtë konfirmon se pajtohet që të kalojë në fondin e ardhshëm pensional”.

Në paragrafët (3) dhe (4) fjalët: "Fondi për sigurimin pensional dhe invalidor i Maqedonisë" zëvendësohen me fjalën "Agjencia", ndërsa pas fjalës "formularit" shtohen fjalët: "dhe dëshmia për kompensimin e paguar".

Në paragrafin (6) pas fjalës "formulari" shtohen fjalët: "dhe dëshmia për kontributin e paguar".

Neni 32

Në nenin 63 paragrafi (2) pas fjalës "bartjes" presja zëvendësohet me pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Neni 33

Në nenin 65 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Kur anëtari i fondit pensional do ta fitojë të drejtën e pensionit invalidor, në pajtim me nenin 132-v të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë, përmes Agjencisë, menjëherë e njofton shoqërinë e cila menaxhon me atë fond pensional, se anëtari e ka fituar të drejtën e pensionit invalidor. Në ditën e parë të ardhshme të bartjes pas ditës së pranimit të njoftimit, shoqëria është e obliguar që t'i bartë mjetet nga llogaria e atij anëtari, në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, përveç në rastet e përcaktuara me nenin 90 të këtij ligji."

Neni 34

Në nenin 66 paragrafi (1) në rreshtin e pestë, pas fjalës "Maqedonisë" shtohen fjalët: "përmes Agjencisë".

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5) si vijon:

"(5) Agjencia i përcakton mënyrën dhe procedurën për bartjen e mjeteve në rastet nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni dhe neni 65 të këtij ligji, si dhe llojin dhe formatin e të dhënave që këmbëhen ndërmjet institucioneve dhe personave të përfshirë në procedurë."

Neni 35

Pas nenit 66 shtohet nen i ri 66-a, si vijon:

"Neni 66-a"

(1) Kontributet e paguara për anëtarin e fondit pensional që e ka revokuar statusin e përcaktuar në bazë të nenit 131 paragrafi (2) të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, barten në Fondin për sigurimin pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

(2) Agjencia i përcakton mënyrën dhe procedurën për bartjen e mjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni."

Neni 36

Në nenin 69 paragrafi (1) pika v) fjalët: "paragrafët (1) dhe (2)", zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (1)".

Pika g) ndryshohet si vijon:

"g) u dërgon të dhëna përmes Agjencisë, shoqërive ose shoqërive për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, lidhur me bartjen e kryer të kontributeve, në pajtim me pikën v) të këtij paragrafi;"

Neni 37

Në nenin 75 paragrafi (3) në pikën a) pas fjalëve: "menaxhim me fonde pensionale" shtohen fjalët: "dhe shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në pikën b) pas fjalës "shoqëri" shtohen fjalët: "dhe shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (4) pas fjalisë së parë shtohet fjalia e re si vijon:

"Shoqëria ose shoqëritë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, janë të obliguara që t'i dorëzojnë materialet për miratim në Agjenci, dhe nuk guxojnë të publikojnë ose emitojnë materiale të palejuara për marketing."

Neni 38

Në nenin 77 në paragrafin (1) pas fjalës "shoqëria" dhe në paragrafin (5) pas fjalëve: "ndonjë shoqërie" shtohen fjalët: "ose shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (3) shtohet fjalia e re si vijon: "Agjenti është i obliguar që të gjitha kontaktet me anëtarin ose me anëtarët që kanë të drejtë të bëhen anëtarë të fondit pensional, t'i kryejë personalisht, dhe nuk guxon që të lidhë marrëveshje për anëtarësim përmes personit tjetër."

Në paragrafin (6) pika b) fjalët: "masa e sigurisë" zëvendësohen me fjalët: "sanksioni kundërvajtës".

Pas paragrafit (10) shtohet paragrafi i ri (11), si vijon:

"(11) Personit të shlyer nga regjistri i agjentëve, sipas paragrafit (8) të këtij neni, nuk do t'i lejohet regjistrimi i sërishëm në regjistër, në afat prej tre vitesh nga data e shlyerjes."

Neni 39

Në nenin 85 në paragrafin (2) dhe (3) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

"(4) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare, janë të obliguara që ta ndryshojnë vlerën e përcaktuar për letrën e caktuar me vlerë, me kërkesën e Agjencisë, nëse ajo gjatë kontrollit konfirmon se ajo shoqëri gjatë vlerësimit e ka shfrytëzuar çmimin e llogaritur jopërkates për letrën me vlerë ose vlera objektive nuk i përgjigjet gjendjes së vërtetë të tregut, si dhe kur janë rrezikuar interesat e anëtarëve."

Neni 40

Në nenet 86 paragrafi (1) dhe 87 paragrafi (1) pika b) fjalët: "mars dhe shtator" zëvendësohen me fjalët: "qershor dhe dhjetor".

Neni 41

Në nenin 88 pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si vijon:
"(3) Agjencia më afërsisht e përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërisë."

Neni 42

Në nenin 94 paragrafi (1) pas fjalës "shoqëri" shtohen fjalët: "ose shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (2) pika zh) fjalët: "para 31 dhjetorit" zëvendësohen me fjalët: "përfundimisht me 31 dhjetor".

Në paragrafin (3) fjalët: "gazetë ditore" zëvendësohen me fjalët: "nga gazetat ditore me tirazh më të madh".

Në paragrafin (5) dhe (6) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 43

Në nenin 95 paragrafët (1), (2) dhe (4) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (3) pas fjalës "shoqëria", shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare", fjalët: "para 31 dhjetorit" zëvendësohen me fjalët: "përfundimisht me 31 dhjetor" dhe fjala "brokerave" zëvendësohet me fjalën: "transaksioneve".

Neni 44

Në nenin 96 paragrafin (1) pikat a) dhe d) pas fjalës "shoqërisë" shtohen fjalët: "ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në pikën v) fjalët: "agjencia brokerë" zëvendësohen me fjalët: "personi juridik që e kryen shërbimin me letra me vlerë".

Në pikën (g) fjala "brokerave" zëvendësohet me fjalën "transaksioneve".

Neni 45

Në nenin 98 paragrafin (1) pikën b) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në pikën v) në rendin e parë pas fjalës "kompensim" fjalët: "nga mjetet në llogarinë e anëtarit të fondit pensional" fshihen.

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Kompensimin nga paragrafi (1) pika v) e këtij neni, e paguan anëtari i fondit pensional që shkon në fondin e ardhshëm pensional. Shoqëria që udhëheq me fondin pensional në të cilin shkon anëtari ose përfaqësuesi i asaj shoqërie, nuk guxon që ta paguajë këtë kompensim."

Pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6), si vijojnë:

"(4) Agjencia për secilin vit kalendarik e përcakton lartësinë maksimale të kompensimit nga paragrafi (1) pika a) e këtij neni, në bazë të të dhënave dhe projekteve reale për numrin e anëtarëve dhe lartësinë e kontributeve, mjetet neto të fondeve të obligueshme pensionale, të dhënave për punën e shoqërive ose shoqërive për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale dhe kompensimet e të gjitha institucioneve të përfshira në sigurimin e detyrueshëm pensional kapital të financuar.

(5) Në aktin nga paragrafi (4) i këtij neni, pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(6) Nëse shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nuk e përcakton kompensimin nga paragrafi (1) pika a) e këtij neni, e paguan kompensimin e përcaktuar në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni."

Neni 46

Në nenin 99 paragrafi (1) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (2) fjalët: "pika b)" zëvendësohet me fjalët: "pika a)".

Neni 47

Në nenin 100 paragrafi (1) pas fjalës: "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet penzionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (2) fjalët: "gazetë ditore" zëvendësohet me fjalët: "nga gazetat ditore më me tirazh."

Paragrafi (4) fshihet.

Neni 48

Neni 101 ndryshon si vijon:

"(1) Provizionet e transaksionit lidhur me transaksionet për fitimin ose bartjen e mjeteve të fondit pensional, paguhen nga mjetet e fondit pensional.

(2) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale është e detyrueshme të bëjë kontroll të provizioneve që paguhen nga mjetet e fondit pensional me të cilin ai menaxhon, në personat e zgjedhur juridik të cilët kryejnë shërbime me letra në vlerë të lidhur drejtpërsëdrejti me tregti me mjetet e fondit pensional, për shkak të sigurisë se ato provizione janë plotësisht konkurrenente me provizionet që i paguajnë persona të tjerë juridik për transaksione të ngjashme. Për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondeve pensionale, Agjencia mund ta ndalojë që personi i lidhur i shoqërisë të kryejë shërbime me letra me vlerë, të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë me mjetet e fondeve pensionale.

(3) Për sigurimin e konkurrencës nga paragrafi (2) i këtij neni, zgjedhja e personave vendorë juridikë që mund të kryejnë shërbime me letra me vlerë, kryhet në bazë të: provizionit më të ulët, vëllimit të tregtisë, aftësimin kadrovik, teknik dhe organizativ. Për t'u zgjedhur personi vendor juridik, duhet të ketë të punësuar së paku dy brokerë të autorizuar, me së paku 2 vite përvojë pune, si broker i autorizuar.

(4) Agjencia e përcakton vëllimin e nevojshëm të tregtisë, aftësimin kadrovik, teknik dhe organizativ.

(5) Zgjedhja e personave juridik që kryejnë shërbime me letra me vlerë, kryhet për periudhën prej 365 ditësh, sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

(6) Agjencia jep pajtim të marrëveshjeve të lidhura në mes shoqërisë ose shoqërisë në menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale dhe personave juridik të cilët kryejnë shërbime me vlerë. Me marrëveshjen shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet e obligueshme pensionale dhe individuale Agjencisë i dërgon edhe tarifën për provizione."

Neni 49

Në nenin 105 paragrafi (1) pika z), ndryshon si vijon:

"z) dokumentet për pjesë dhe aksione të fondeve investuese në Republikën e Maqedonisë, që kanë leje nga Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë;"

Paragrafi (2) ndryshon, si vijon:

"Tregtia me letra me vlerë e fondeve pensionale, kryhet në tregjet e rregulluara sekondare, në tregje përmes sporteleve dhe në tregjet primare, për instrumentet që i plotësojnë kushtet nga ky nen."

Në paragrafin (4) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 50

Në nenin 106 paragrafët (4) dhe (6) pas fjalës "fonde" shtohen fjalët: "dhe shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (5) fjalët: "para datës kur do të fillojë pagesa e kompensimit në sigurimin e detyrueshëm pensional kapital të financuar, në pajtim me nenin 58 paragrafi (4) i këtij ligji" fshihen.

Neni 51

Në nenin 107 paragrafi (1) pika a) në rreshtin e shtatë numri "5" zëvendësohet me numrin „10”.

Në pikën gj) numri "20" zëvendësohet me numrin "5".

Neni 52

Në nenin 110 pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në pikat a) dhe b) fjalët: "në tregun e rregulluar dhe institucionalizuar dytësor" zëvendësohet me fjalët: "e kryer përmes bursës së letrave me vlerë e autorizuar nga Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë përkatësisht organi përkatës kompetent, në rast të investimit të mjeteve jashtë vendit".

Neni 53

Në nenin 111 paragrafin (1) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare", ndërsa fjalët: "si fshehtësi afariste" zëvendësohen me fjalët: "sipas klasifikimit me shkallën përkatëse të fshehtësisë, në pajtim me ligjin".

Pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

"(4) Agjencia e përcakton mënyrën e pengimit të keqpërdorimit të informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, të marra si rezultat i pozitës zyrtare."

Neni 54

Pas nenit 111 shtohet nen i ri 111-a, si vijon:

"Neni 111-a

(1) Personat nga neni 111 paragrafi (1) i këtij ligji janë të obliguar që ta njoftojnë Agjencinë për çdo transaksion me letra me vlerë, që e kanë lidhur në emër të vet dhe për llogari të vet, në çdo 180 ditë ose më shkurt me kërkesën e Agjencisë.

(2) Agjencia e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit, nga paragrafi (1) i këtij neni."

Neni 55

Në nenin 115 paragrafin (1) pas fjalës "shoqëria" shtohen fjalët: "ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Në paragrafin (2) fjalia e dytë ndryshon si vijon: "Nënruajtësi i zgjedhur i pronës, doemos duhet t'i plotësojë kushtet nga neni 116 paragrafi (1) pikat b) dhe v) të këtij ligji, dhe ta ketë rejtingun e rekomandueshëm për investim sipas agjencive kreditore me renome ndërkombëtare. Agjencia më afërsisht i përcakton kriteret për rangimin e nënruajtësit të pronës."

Neni 56

Në nenin 127 paragrafin (1) fjalët: "menaxhim me fondin pensional" dhe në nenin 129 pas fjalëve: "menaxhim me fondet pensionale" shtohen fjalët: "shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të obligueshme dhe vullnetare".

Neni 57

Titulli i Kreut XVI ndryshon si vijon: "DISPOZITA NDËSHKUESE DHE KUNDËRVAJTËSE".

Titulli nën pikën b) ndryshon si vijon: "Dispozita kundërvajtëse".

Neni 58

Neni 130, ndryshon si vijon:

"Neni 130

Organ kundërvajtës

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 133, 134, 135, 136, 136-a dhe 136-b nga ky ligj, procedurë kundërvajtëse udhëheq edhe sanksion kundërvajtës kumton Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtjen (në tekstin në vijim: Komisioni kundërvajtës).

(2) Drejtori i Agjencisë i cakton anëtarët e komisionit kundërvajtës, nga radhët e personave zyrtarë të autorizuar të punësuar në Agjenci, ndërsa mund ta caktojë edhe sekretarin e Komisionit kundërvajtës.

(3) Komisioni kundërvajtës përbëhet nga tre anëtarë, prej të cilëve njëri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit kundërvajtës, si vijon:

- kryetari duhet doemos të jetë jurist i diplomuar, me provimin e dhënë të jurisprudencës dhe së paku pesë vite përvojë pune në sferën e vet dhe

- dy anëtarë me përgatitje sipërore profesionale dhe së paku pesë vite përvojë pune, relevante për fondet pensionale nga sfera e drejtësisë, ekonomisë, financave, kontabilitetit, investimit, sigurimit ose shkencës aktuale.

(4) Anëtarët e Komisionit kundërvajtës, kanë të drejtë kompensimi për punën e tyre në Komisionin për kundërvajtje, lartësinë e të cilit e cakton drejtori i Agjencisë që duhet të jetë e arsyeshme dhe përkatëse me rëndësinë, vëllimin e punës së anëtarëve dhe ndërlikueshmërisë së kundërvajtjeve."

Neni 59

Neni 131 ndryshon si vijon:

"Neni 131

Puna e Komisionit për kundërvajtje

(1) Anëtarët e Komisionit për kundërvajtje janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e Komisionit për kundërvajtje, dhe vendosin në bazë të njohurisë së vet profesionale dhe bindjes së pavarur.

(2) Komisioni për kundërvajtje ka të drejtë që të paraqesë dëshmi dhe të grumbullojë të dhëna që janë të domosdoshme për konfirmimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë të tjera dhe të ndërmarrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose ligj tjetër.

(3) Komisioni për kundërvajtje sjell vendime për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj dhe kumton sanksione kundërvajtëse të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje, me të cilat kumtohet sanksion kundërvajtës, mund të paraqitet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës administrative.

(5) Komisioni për kundërvajtje mban evidencë unike të kundërvajtjeve, sanksioneve të kumtuara dhe vendimeve të miratuara. Agjencia e përcakton mënyrën e evidencës dhe mënyrën e qasjes të informimit që janë të përmbajtura në evidencë.

(6) Komisioni për kundërvajtje, miraton rregullore për punën e vet."

Neni 60

Neni 132 ndryshon si vijon:

"Neni 132

Barazimi

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 133, 134, 135, 136, 136-a, 136-b, 136-v, 136-g dhe 136-d të këtij ligji, personat e autorizuar për kontroll, janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim, para se të parashtrijnë kërkesë për procedurë kundërvajtëse.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet që të ngrihet procedura për barazim, personi i autorizuar për kontroll përpilon procesverbal, në të cilin shënohen elementet e rëndësishme për kundërvajtjen, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat që janë gjendur në vendin e ngjarjes dhe mënyra se si do të evitohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja.

(3) Personi i autorizuar për kontroll mundet që në procedurën për barazim, kryerësit të kundërvajtjes t'i japë urdhërpagese.

(4) Nëse kryerësi nuk e merr urdhërpagesën, është i obliguar që të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës nga kryerësi, shënohet në procesverbal.

(5) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën do ta nënshkruajë personi përgjegjës përkatësisht zyrtar, që është gjendur aty për aty gjatë kontrollit, ose personi tjetër zyrtar ose përgjegjës që ka deklaruar se ka të drejtë që ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(6) Deklarata nga paragrafi (5) shënohet në procesverbal.

(7) Personi i autorizuar për kontroll, është i obliguar që të mbajë evidencë për procedura e ngritura dhe për përfundimin e tyre."

Neni 61

Neni 133 ndryshon si vijon:

"(1) Gjopa në shumë prej 40.000 deri në 50.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqërisë për udhëheqje me fondin pensional ose shoqërisë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nëse:

1) themelon më tepër se një fond pensional për kohën prej dhjetë vitesh, pas datës kur do të fillojë pagesa e kontributit në sigurimin e detyrueshëm pensional kapital të financuar, në pajtim me nenin 58 paragrafi (4) i këtij ligji, në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) i këtij ligji;

2) nuk i mundëson qasje të librat, dokumentet dhe evidenca tjetër, personit të autorizuar që kryen kontroll në emër të Agjencisë, dhe nuk i eviton parregullsitë në pajtim me neni 53 paragrafët (3) dhe (6) të këtij ligji;

3) mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional i jep si peng, asignacion ose i bart në dobi të personave të tretë, në kundërshtim me nenin 67 paragrafi (3) i këtij ligji;

4) nuk i shpërndan kontributet, mjetet e bartura dhe të ardhurat nga investimet në llogaritë individuale të anëtarëve të fondeve pensionale, dhe nuk mban evidencë në pajtim me nenin 81 të këtij ligji;

5) nuk i shndërron mjetet nga kontributet dhe mjetet e bartura në njësi përlllogaritëse, në pajtim me nenin 82 të këtij ligji;

6) e kryen vlerësimin e mjeteve të fondit pensional në kundërshtim me rregullat e përmbajtura në nenin 83 të këtij ligji;

7) nuk bën përlllogaritjen e neto mjeteve të fondit dhe të vlerës së njësisë llogaritëse në secilën datë të vlerësimit, dhe nuk e ndryshon vlerën e përcaktuar të letrës së caktuar me vlerë, në pajtim me nenin 85 paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji;

8) e udhëheq kontabilitetin e shoqërisë dhe të fondit pensional në kundërshtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe standardet ndërkombëtare, sipas nenit 88 të këtij ligji;

9) arkëton kompensime në mënyrë dhe shuma që nuk janë të parapara në nenet 98 dhe 99 të këtij ligji;

10) kompenson shpenzime në kundërshtim me nenin 103 të këtij ligji;

11) investon mjete të fondit pensional, në kundërshtim me principet, qëllimet, instrumentet dhe kufizimet në nenet 104, 105, 107 dhe 108 të këtij ligji;

12) shet, blen ose shfrytëzon mjete në kundërshtim me kufizimet nga neni 110 i këtij ligji;

13) ia beson udhëheqjen me mjete të fondit pensional ose e bart përgjegjësinë për atë të personi tjetër, në kundërshtim me nenin 112 të këtij ligji;

14) ngarkohet me borxh në kundërshtim me qëllimet dhe kufizimet nga neni 113 i këtij ligji;

15) ruajtësi i zgjedhur i pronës, nuk i plotëson kushtet nga neni 116 i këtij ligji;

16) nuk e zgjedh ruajtësin e pronës të cilit ia beson përgjegjësinë për ruajtje të mjeteve nga fondi pensional, ose nuk ka marrëveshje të përhershme me ruajtësin e pronës, në pajtim me nenet 115 paragrafët (1) dhe (2) dhe 119 të këtij ligji;

17) nuk i plotëson obligimet e parapara në nenin 122 paragrafët (1) pika a) dhe b) dhe (2) të këtij ligji;

18) nuk e siguron kryerjen e pandërprerë të shërbimeve për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional, në pajtim me nenin 123 paragrafi (1) i këtij ligji;

19) vepron në kundërshtim me nenin 125 paragrafi (5) nga ky ligji dhe

20) nuk i bart të drejtat e veta për ndërmarrjen e veprimeve juridike të Agjencisë, në pajtim me nenin 126 paragrafi (5) i këtij ligji.

(2) Gjoha deri në shumë të dhjetëfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i kumtohet shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, ka përfituar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(3) Gjoha në shumë prej 40.000 deri në 50.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqërisë për udhëheqje me fondin pensional, nëse:

1) kryen veprimtari që nuk janë të parapara me nenin 7 paragrafi (1) i këtij ligji;

2) nuk e zmadhon kapitalin aksionar, në pajtim me nenin 10 paragrafi (2) i këtij ligji;

3) nuk e paguan kapitalin, në mënyrën e përcaktuar me nenin 11 të i këtij ligji;

4) kapitali themelues rrjedh nga burimet që nuk i lejon neni 12 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

5) nuk e mban dhe nuk e zmadhon kapitalin e paguar, të llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia dhe nuk mban mjetet likuidimi në shumë jo më të vogël se përqindja nga kapitale themelues, në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;

6) nuk e kryen harmonizimin përkatës në afat prej gjashtë muajsh, në pajtim me nenin 14 paragrafi (5) i këtij ligji;

7) nuk kërkon pëlqim për çdo fitim ose bartje të aksioneve në pajtim me nenin 16 paragrafi (1) i këtij ligji;

8) blen aksione të shoqërisë tjetër për menaxhim me fonde pensionale, ose riorganizohet, në kundërshtim me nenin 16 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji;

9) kryen ndryshime pa leje paraprake nga agjencia, në pajtim me nenin 39-e të këtij ligji.

(4) Gjoha deri në shumë të dhjetëfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni, do t'i kumtohet shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale, nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni, ka përfituar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(5) Gjoha në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale ose në shoqërinë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale, ndërsa për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni vetëm personit përgjegjës në shoqërinë për menaxhim me fondet e obligueshme vullnetare pensionale.

(6) Gjoha deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (5) i këtij neni, do t'i kumtohet personit përgjegjës nga paragrafi (5) i këtij neni, nëse kundërvajtjen e ka kryer për përfitim material.

Neni 62

Neni 134 ndryshon, si vijon:

"(1) Gjoha në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqërisë për udhëheqje me fondin pensional ose shoqërisë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nëse:

- 1) i shfrytëzon mjetet e veta për dedikimet e ndaluara me nenin 20 të këtij ligji;
- 2) nuk i përmbush kërkesat e parapara nga neni 21 i këtij ligji;
- 3) nuk e dorëzon parashtrësën për shkëputjen e marrëveshjes dhe nuk e themelon llogarinë personale, në pajtim me nenin 59 paragrafi (1) dhe (5) të këtij ligji;
- 4) realizon kontakt ose komunikim me anëtarin, në periudhën kur anëtari ka lidhur marrëveshje të përkohshme për anëtarësim, në kundërshtim me nenin 61 paragrafi (5) i këtij ligji;

5) nuk i përmbush obligimet nga neni 63 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji;

6) nuk i bart në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, mjetet nga llogaria e anëtarit të fondit pensional, i cili ka fituar të drejtën e pensionit invalidor, në pajtim me nenin 65 të këtij ligji;

7) nuk i plotëson obligimet e veta në rast të vdekjes së anëtarit të fondit pensional, të parapara në nenin 66 të këtij ligji;

8) jep ose publikon informatat të gabueshme për fondin, që mund t'i hutojnë anëtarët ekzistues apo të ardhshëm të fondit, ose jep deklarata apo parashikime për rezultatet e ardhshme investuese për fondin pensional, si dhe nuk dorëzon për miratim në agjenci ose publikon material të palejuar për marketing, dhe nuk vepron sipas aktvendimit të Agjencisë sipas nenit 75 paragrafët (1), (2), (4) dhe (5) të këtij ligji.

9) zbaton procedura marketingu të fondit pensional, të ndaluara me nenin 79 të këtij ligji;

10) nuk e përcakton fitimin e fondit pensional, me të cilin udhëheq në pajtim me nenin 86 të këtij ligji;

11) nuk e plotëson obligimin për informimin e rregullt të anëtarëve të fondit pensional, në pajtim me nenin 95 të këtij ligji;

12) nuk i dorëzon informata dhe të dhëna Agjencisë, ose i dorëzon informata dhe të dhëna të gabueshme, në pajtim me nenin 96 të këtij ligji;

13) nuk i njofton Agjencinë dhe të gjithë anëtarët e fondit pensional, për secilin ndryshim të lartësisë së kompensimeve, në mënyrë dhe afatet e parapara në nenin 100 të këtij ligji;

14) nuk e siguron konkurrencën e plotë të provizioneve, në pajtim me nenin 101 të këtij ligji;

15) investon mjete të fondit pensional, në kundërshtim me kufizimet e parapara me nenin 106 dhe 109 të këtij ligji;

16) nuk e njofton Agjencinë, kur do të heq dorë nga marrëveshja për ruajtje të pronës, në pajtim me nenin 121 të këtij ligji dhe

17) nuk vepron në pajtim me qëndrimet dhe mendimet e paraqitura në aktet e Agjencisë.

(2) Gjoha deri në shumë të pesëfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i kumtohet shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, ka përfiturar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(3) Gjoha në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqërisë për udhëheqje me fondin pensional, nëse:

1) nuk e cakton revizorin e jashtëm të autorizuar me referenca të mira dhe nuk e publikon ekstraktin e raportit të reviduar financiar, me mendimin e revizorit të autorizuar, në pajtim me nenin 22 të këtij ligji.

(4) Gjoha deri në shumë të pesëfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni, do t'i kumtohet shoqërisë për udhëheqje me fonde pensionale, nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni, ka përfiturar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(5) Gjoha në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale ose në shoqëri për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale, ndërsa për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni vetëm personit përgjegjës në shoqërinë për menaxhim me fondet e obligueshme vullnetare pensionale.

(6) Gjoha deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (5) i këtij neni, do t'i kumtohet personit përgjegjës në shoqërinë nga paragrafi (5) i këtij neni, nëse kundërvajtjen e ka kryer për përfitim material."

Neni 63

Neni 135 ndryshon si vijon:

"(1) Gjoha në shumë prej 9.000 deri në 10.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoqërisë për udhëheqje me fondet e obligueshme pensionale ose shoqëritë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale, nëse:

1) nuk vepron sipas kërkesave të parapara në nenin 39e të këtij ligji;

2) e refuzon anëtarësimin e të siguruarit që i plotëson kushtet e përcaktuara me ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, sipas nenit 59 paragrafi 7 i këtij ligji;

3) nuk e dorëzon marrëveshjen e përkohshme për anëtarësim, në Agjenci në afatin e parapara me nenin 61 paragrafi (1) i këtij ligji;

4) nuk ia siguron kushtet anëtarit të fondit pensional që ka pushuar të paguajë kontribute në fond para pensionimit, në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

5) kryen marketing të fondit pensional personit në lokalet e tij të punës, në kundërshtim me nenin 76 të këtij ligji;

6) lidh marrëveshje për anëtarësim ose marrëveshje të përkohshme për anëtarësim, me personin fizik pa ndërmjetësimin e agentit, në kundërshtim me nenin 77 paragrafi (1) i këtij ligji;

7) nuk i respekton kërkesat lidhur me publikimin e prospektit informativ, të përmbajtur në nenin 94 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji dhe

8) nuk i mundëson shikim në prospektin informativ dhe në statutin e fondit të vet, secilit person që do të paraqitet për anëtarësim në atë fond ose anëtarit të vet, në kundërshtim me nenin 94 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

(2) Gjoha deri në shumë të pesëfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i kumtohet shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, ka përfituar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(3) Gjoha në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, edhe personit përgjegjës të shoqërisë për menaxhim me fonde të obligueshme pensionale ose shoqëri për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale.

(4) Gjoha deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni, do t'i kumtohet personit përgjegjës të shoqërisë për menaxhim me fonde e obligueshme pensionale ose shoqëri për menaxhim me fondet e obligueshme dhe vullnetare pensionale, nëse kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, e ka kryer për përfitim material."

Neni 64

Neni 136 ndryshon si vijon:

"(1) Gjoha në shumë prej 40.000 deri në 50.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje ruajtësit të pronës, nëse:

1) nuk i mundëson qasje te librat, dokumentet dhe evidenca tjetër, personit të autorizuar që kryen kontroll në emër të Agjencisë, në pajtim me nenin 53 paragrafi (3) i këtij ligji;

2) nuk e kryen ruajtjen e mjeteve, punën lidhur me ato mjete dhe evidencën e fondeve pensionale, veç e veç për secilin fond pensional, të ndarë nga komitentët e tjerë dhe të ndarë nga mjetet e veta, punën dhe evidencën në pajtim me nenin 115 paragrafi (4) i këtij ligji;

3) nuk i përmbush kushtet nga neni 116 i këtij ligji;

4) nuk i përmbush obligimet, nga neni 117 i këtij ligji;

5) nuk e njofton menjëherë Agjencinë në rast të thyerjes së marrëveshjes për ruajtjen e pronës, ligjit ose për veprimin në kundërshtim me interesat e anëtarëve të fondit pensional, të kryer nga ana e shoqërisë ose cilitdo person tjetër, në pajtim me nenin 118 të këtij ligji;

6) i mbulon dëmet nga mjetet e fondit pensional, në kundërshtim me nenin 120 paragrafi (2) i këtij ligji.

7) nuk e siguron besueshmërinë e plotë të të dhënave, në pajtim me nenin 120 paragrafi (4) i këtij ligji;

8) nuk e njofton Agjencinë, kur do të heq dorë nga marrëveshja për ruajtje të pronës, në pajtim me nenin 121 të këtij ligji dhe

9) në rast të shkopitjes së marrëveshjes për ruajtjen e pronës, nuk i plotëson obligimet nga neni 123 paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Gjoha deri në shumë të dhjetëfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i kumtohet ruajtësit të pronës, nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, ka përfituar dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(3) Gjoha në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, edhe personit përgjegjës të ruajtësi i pronës.

(4) Gjoha deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni, do t'i kumtohet personit përgjegjës të ruajtësi i pronës, nëse kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, e ka kryer për përfitim material."

Neni 65

Pas nenit 136 shtohet neni i ri 136a, si vijon:

"Neni 136a

Gjoha në shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik, nëse:

1) si agjent i shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale, nuk u përmbahet obligimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 77 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji dhe

2) nuk u përmbahet obligimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 77 paragrafët (3) dhe (5) të këtij ligji."

Neni 66

Pas nenit 136-a shtohet nen i ri 136-b, si vijon:

"Neni 136b

Gjoha në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik, nëse:

1) bëhet anëtar i më tepër se një fondi pensional, në kundërshtim me nenin 59 paragrafi (8) i këtij ligji, përveç në rastet kur kjo lejohet në pajtim me nenin 59 paragrafi (9) i këtij ligji."

Neni 67

Pas nenit 136-b shtohet nen i ri 136-v, si vijon:

"Neni 136-v

(1) Gjoha në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, nëse:

1) nuk i paguan kontributet në fondet pensionale të zgjedhura nga ana e anëtarëve, në përqindje dhe afate të përcaktuara me nenet 60 dhe 69 paragrafi (1) pika v) e këtij ligji;

2) nuk i përmbush obligimet e parapara në nenin 68 paragrafi (1) i këtij ligji dhe

3) nuk u dërgon shoqërive të dhëna lidhur me pagesën e kontributeve, në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) pika g) e këtij ligji.

(2) Gjoha në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, edhe personit përgjegjës të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

(3) Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve kundërvajtëse nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, është gjyqi kompetent."

Neni 68

Pas nenit 136-v shtohet nen i ri 136-g, si vijon:

"Neni 136-g

(1) Gjoha në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen personit përgjegjës në Agjenci, nëse pranon funksion ose punësim ose fiton aksione, në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji.

(2) Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni, është gjyqi kompetent."

Neni 69

Pas nenit 136-g shtohet nen i ri 136-d, si vijon:

"Neni 136-d

(1) Gjoha në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen personit juridik, që është paraqitur për leje për themelimin e shoqërisë, dhe në dokumentacionin e dorëzuar ka paraqitur të dhëna të pasakta, në kundërshtim me nenin 39-v të këtij ligji.

(2) Gjoha në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, edhe personit përgjegjës te personi juridik.

(3) Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve kundërvajtëse nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, është gjyqi kompetent."

Neni 70

Agjencia mundet me kërkesën e personit të fondit pensional, ta anulojë regjistrimin e tij në Regjistrin e anëtarëve, nëse vlerësimet e pensionit të ardhshëm, në bazë të moshës dhe stazhit të tij, deri në anëtarësimin në sigurimin e detyrueshëm pensional kapital të financuar, tregojnë se anëtarësimi është në kundërshtim me interesat e tij.

Anëtari i fondit pensional mund të paraqesë kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni në Agjenci, më së voni në afat prej 180 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Neni 71

Lartësinë maksimale të kompensimit nga kontributi që Agjencia e përcakton në pajtim me nenin 36 paragrafi (3) i këtij ligji, për vitin 2008 do ta përcaktojë për periudhën e mbetur nga ky vit.

Neni 72

Deri në nxjerrjen e ligjit për pagesën e pensionit përmes anuiteteve ose tërheqjeve të programuara, kur anëtari i fondit pensional do ta fitojë të drejtën e pensionit sipas pleqërisë sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mundet ta tërheqë tërë shumën nga llogaria e tij individuale.

Deri në nxjerrjen e ligjit për pagesën e pensionit përmes anuiteteve ose tërheqjeve të programuara, kur anëtari i fondit pensional nuk do ta fitojë të drejtën e pensionit sipas pleqërisë sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, për arsye se nuk i ka mbushur së paku 15 vite stazh, mundet ta tërheqë tërë shumën nga llogaria e tij individuale.

Neni 73

Në tërë tekstin e ligjit fjalët: "fondi pensional" në nene dhe numra të ndryshëm zëvendësohen me fjalët: "fondi i detyrueshëm pensional."

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka të bëjë me nenet 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 55 dhe 56.

Neni 74

Dispozitat nënligjore që dalin nga ky ligj, do të nxirren në afatin prej 180 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 75

Dispozitat nga neni 15 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2008.

Neni 76

Me fillimin e zbatimit të dispozitave nga neni 15 i këtij ligji pushojnë që të vlejnë dispozitat nga Kreu III, me nenet 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 nga Ligji për sigurimin e obligueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005 dhe 29/2007).

Neni 77

Në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqërive ekzistuese për udhëheqje me fonde pensionale, të cilave u janë lëshuar leje për udhëheqje me fonde pensionale për periudhën prej dhjetë vitesh, Agjencia do t'u lëshojë leje për udhëheqje me fonde pensionale me kohëzgjatje të pakufizuar.

Neni 78

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".